

VENDIM Nr.77

Ankuesi: Vasilika Hysi

Kundër: Joq Albania

Linku i video-s në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=MOnCcHuiu2A>

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI

1. Informacioni i transmetuar në video është i paverifikuar, pasi ngrihen akuza të cilat nuk mbështeten në fakte.
2. Video ka elementë të shumtë të cilët akuzojnë znj. Vasilika Hysi dhe për këtë arsye duhet që, gazetari të kontaktonte me avokaten për të dhënë edhe opinion e saj në lidhje me ngjarjen.
3. Informacioni i transmetuar në video është i pabalancuar pasi znj. Hysi nuk ka marrë të njëjtën hapësirë për t'u shprehur në lidhje me akuzat që i janë bërë. Dhënia e reagimit të avokates të vendosur më pas në "Discription" nuk ka të njëjtin vizibilitet si në video.
4. Akuzat e ngritura për znj. Vasilika Hysi nuk provohen për këtë arsye, video cënon reputacionin e saj.

Nenet e shkelura sipas Kodit të Etikës së Gazetarit:

Neni 1. Saktësia dhe Ndershmëria e Informacionit¹. Gazetarët duhet të bëjnë çmos për të ofruar raportim të paanshëm dhe të balancuar. Palët e kritikuara duhet të kenë të drejtën t'u përgjigjen akuzave. Gazetari duhet të verifikojë informacionin para botimit me qëllim që të sigurohet që është i saktë, i bazuar në fakte dhe i besueshëm.

Neni 9. Ndërhyrja në jetën private². Media dhe gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve që bëhen objekte të interesit të tyre profesional.

Mbështetur në këto arsyeime, Bordi,

VENDOSI

T'i sugjerojë medias Joq Albania të fshijë videon nga YouTube

Publikuar më 21 Korrik 2023

¹ Gazetarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i kontaktuar të gjitha palët dhe për të mbledhur të gjitha opinionet relevante.

² Media dhe gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve që bëhen objekte të interesit të tyre profesional.